

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

Detyra 1

Gjithsej **2 pikë**

A) Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë nëse ka shkruar saktë pyetjen nr. 6.** / A keni kontaktuar me ndonjë nga skulptorët e Kolonisë?

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë pyetjen nr. 4 / Pyetja: A ndalesh ndonjëherë të shikosh ndonjëherë nga skulpturat e reja?

Detyra 2

Nxënësi merr **1 pikë** për katër ose pesë përgjigje të sakta:

86,66% e nxënësve dinë se çfarë është dhe ku gjindet Kolonia e Artit. Rezultatet tregojnë se nxënësit më shpesh shkojnë në Koloni të organizuar se sa vetëm, dhe për këtë më shpesh vajzat se sa djemtë.

62,50% e vajzave dhe madje **85,71%** e djemve kanë vëzhguar skulptorët duke punuar, por janë pak, vetëm **20%** prej tyre kanë kontaktuar me ta.

80% e nxënësve do t'i çonin mysafirët në Koloni.

Detyra 3

Ka rrethuar numrin: 2 Plaku- **1 pikë**

Detyra 4

Merr **1 pikë** nëse shkruan: guximi.

Detyra 5

Gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr **2 pikë për përgjigje plotësisht të saktë:**

Veta e tretë.

Dialogu në mes:

Plakut dhe djalit.

Nxënësi merr **1 pikë për njëherë nga përgjigjet e shkruara saktë.**

Detyra 6

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: miqësie (dhe përgjigje të tjera të sakta) .

Detyra 7

Gjithsej **2 pikë**:

A) nëse ka rrethuar numrin: 2 epitete-**1 pikë**

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: Epiteti është një fjalë përcaktuese, zakonisht mbiemër, që i shtohet një emri për t'i pasuruar kuptimin, duke i dhënë bukuri artistike, duke shprehur një vlerësim, një qëndrim nga autori, ose duke i vënë në dukje një anë. (dhe përgjigje të tjera të sakta)

Detyra 8

dysHEME – **1 pikë** (dhe përgjigje të tjera të sakta)

Detyra 9

Gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Direku –emër; ishte- folje; i gjatë- mbiemër; pothuaj-ndajfolje; sa-lidhës; kasollja-emër.

Nxënësi merr **1 pikë** për katër ose pesë përgjigje të sakta.

Detyra 10

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Do të hash-veta e dytë, numri njëjës

Do të ha-veta e parë, numri njëjës

Do të ta ndez- veta e parë, numri njëjës

Detyra 11

Gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Udhës-dhanore; kasollja-emërore; e plakut-gjinore; kasolle-kallëzore; dera- emërore.

Nxënësi merr **1 pikë** për tri ose katër përgjigje të sakta.

Detyra 12

Gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Ndahen me presje gjymtyrët homogjene që bashkohen me lidhëzën kundërshtore po (por) (dhe përgjigje të tjera të sakta) – **2 pikë**

Detyra 13

Gjithsej **2 pikë**: nxënësi merr nga 1 pikë për çdo përgjigje plotësisht të saktë:

1. stili letrar-artistik (1 pikë)
2. stili shkencor (1 pikë)

Detyra 14

Gjithsej **3 pikë** – nga 1 pikë për përgjigje plotësisht të saktë (autori, gjinia letrare, lloji letrar)

VEPRA	AUTORI	GJINIA LETRARE	LLOJI LETRAR
<i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur</i>	Ismail Kadare	Epikë	Roman
<i>Plaku dhe deti</i>	Ernest Heminguej	Epikë	Novelë
<i>Kulla</i>	Anton Pashku	Epikë	Tregime

Detyra 15

Gjithsej **2 pikë**: Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Tipari dramatik	PO	JO	DËSHMIA NGA FRAGMENTI
Në fragment ka role	PO	JO	Zefi, Nita
Në fragment ka emocion	PO	JO	Babë, o babë, ku je?... Ç'të bëj pa ty?... Të pres akoma, të pres?... oh!
Në fragment ka narracion	PO	JO	
Në fragment ka akte/pamje	PO	JO	

Nxënësi merr **1 pikë** për dy ose tri përgjigje të sakta.

Detyra 16

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: motivi i buzëqeshjes, poezi lirike e dashurisë, mungesë pikësimi.

Detyra 17

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje të saktë: Funkzioni i krahasimit duhet të tregojë dashurinë për subjektin lirik (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)

Detyra 18

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

Bie fjala; b.f.

Era e re; e.r.

Për shembull; p.sh.

Detyra 19

Gjithsej **2 pikë**

A) zbatoj – **1 pikë**

B) shkruhen me z- kur ndiqen nga një bashkëtingëllore e zëshme (*dhe përgjigje të tjera të sakta*) – **1 pikë**

Detyra 20

Skema për vlerësimin e hartimit "Në orë më cingëroi zilja e telefonit".

Përmbajtja– 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse shkurtimisht shkruan përse nuk e ka fikur telefonin para fillimit të orës.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse përmend reagimin e arsimtarit/arsimtares dhe shokëve kur e dëgjojnë zilen e telefonit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse shkurtimisht shkruan se si është ndjerë në atë moment.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse shkurtimisht shkruan për reagimin e vet.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë**Kërkesa 5.**

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse shkruan se si ka përfunduar ajo ngjarje.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë**Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë**

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Leksiku	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, përdorimi i figurave stilistike 2 pikë	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës) 2 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij 1 pikë	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike 1 pikë
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, por pa përdorimin e figurave stilistike pjesërisht e saktë 1 pikë			

2 pikë

Gjithsej 4 pikë

GRAMATIKA

→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)

pjesërisht e saktë

- 1 pikë

DREJTSHKRIMI

→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)

pjesërisht e saktë

- 1 pikë

Gjithsej 2 pikë